

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Bsc në “Shkenca Politiko-Administrative”

Universiteti Privat “Albanian University”

**Eksperti i vlerësimit të jashtëm:
PhD. Ilir Kalemaj**



Korrik / 2017

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Bsc në Shkenca Politiko-Administrative

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Privat "Albanian University"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Shoqërore
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Licensuar me shkresë nga MAS me nr. 8987 prot, datë 27.12.2005
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Akredituar me kusht sipas Urdhërit Nr. 77, datë 09.04.2009 Sipas Urdhërit Nr. 532, datë 27.11.2010 (disa ndryshime në urdhërin nr. 77, datë 09.04.2009) pikat 3 dhe 4 të urdhërit Nr. 77, datë 09.04.2009 revokohen
	Urdhëri mbi heqjen e kushteve	Janë hequr kushtet e akreditimit për programin e studimit sipas Urdhërit Nr. 353, datë 29.08.2013
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në Shkenca Politiko-Administrative
6	Cikli i studimit:	Cikli i parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	6
16	Aktivizimi i programit të studimit	2005 - 2006
17	Numri i studentëve për programin e studimit	245 (*)

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim

**Ky numër përfshin studentët e regjistruar për vitet akademike 2014 -2016*



HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Shkenca Politiko-Administrative

Programi i studimit bachelor në Shkenca Politiko – Administrative, është licensuar me Shkresë Nr. 8981 Prot, datë 27.12.2005 nga MAS. Akreditimi i parë për këtë program studimi është bërë me Urdhër Nr. 77, datë 09.04.2009 “AKREDITIM ME KUSHT TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE SHOQËRORE DHE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT “SHKENCA POLITIKO - ADMINISTRATIVE” TË SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE “UFO DENTAL” mbështetur në VKA Nr.3, datë 17.02.2009. Sipas Urdhërit Nr. 532, datë 27.11.2010 (për disa ndryshime në urdhërin nr. 77, datë 09.04.2009) pikat 3 dhe 4 të urdhërit nr. 77, datë 09.04.2009 revokohen. Me urdhër nr. 353, datë 29.08.2013 “PËR HEQJEN E KUSHTEVE TË AKREDITIMIT PËR PROGRAMIN E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË “BACHELOR” NË “SHKENCA POLITIKO ADMINISTRATIVE” hiqen kushtet për këtë program studimi. Në sqarimet e tij, Albanian University deklaroi se ky program studimi përmendet, ndoshta gabimisht, në Urdhërin Nr. 541, datë 01.12.2010 "Për disa ndryshime në Urdhërin Nr. 355, datë 03.11.2009 "Për akreditimin me kusht të disa programeve të studimit të Shkollës së Lartë Universitare Private UFO University" - mirëpo në UMASH Nr. 355 nuk përmendet fare programi i studimit Bachelor në Shkenca Politiko - Administrative, por disa programe të tjera.

Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative, si pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Shoqërore ofron vetëm programin BSc në Shkenca Politiko-Administrative për ciklin e parë të studimeve, si dhe 5 programe master dhe 2 programe master të ciklit të tretë. Subjekt i këtij vlerësimi është vetëm programi i studimit të ciklit të parë, Bsc në Shkenca Politiko-Administrative.

Universiteti Privat “Albanian University”, me shkresë Nr. 221/1 prot, datë 19.07.2017 ka sjellë në ASCAL “Kthim përgjigje për draft raportin e vlerësimit të jashtëm për programin e studimit bachelor në shkenca politiko administrative”. Eksperti i vlerësimit të jashtëm i pa me kujdes këto komente, dhe merr në konsideratë komentet e mëposhtme duke reflektuar ndryshimet në raportin përfundimtar. Komentet e tjera nuk u konsideruan nga Eksperti duke lënë të pa ndryshuar atë çka paraqitet në Draft - Raport.

1. Sygjerimet për kriterin 6 standarti V. 2
2. Sygjerimet për rubrikën 5 faqe 15 të raportit
3. Sygjerimet për rubrikën 8 faqe 24 të raportit
4. Sygjerimet për rubrikën 11 faqe 30 të raportit

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

PhD Ilir Kalemaj

Gjatë gjithë procedurës, eksperti i jashtëm i vlerësimit është asistuar nga specialistja e ASCAL Znj. Majlinda Demirneli.

ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkimore

Gjatë shqyrtimit paraprak të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm dhe intervistave dhe komunikimit në terren, pamë se qëllimet e objektivave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor ishin në nivelet e kërkuara dhe të standartizuara sipas kërkesave të LAL dhe në përputhje me strategjinë e miratuar nga vetë Albanian University. Përveç strategjisë holistike në nivel makro, ku përcaktohen qartë objektivat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të institucionit, Universiteti Privat "Albanian University" kishte dhe strategji sektoriale, si strategjia e zhvillimit për zyrën e Karrierës, Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve, të cilat në tërësi përcaktonin një sërë masash dhe planesh në përputhje me objektivat e institucionit në tërësi dhe departamentit të shkencave politike në veçanti.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit; Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që	Misioni i programit të studimit përputhet me qëllimet dhe misionin e Institucionit. Programi materializon objektivat strategjikë të IAL në fushën e edukimit dhe kërkimit . Programi i studimit Bachelor në Shkenca Politiko Administrative ka renditur objektivat që synon të realizojë nga përftimi i dijeve, aftësive dhe kompetencave profesionale që studentët priten të nxënë në përfundim të ciklit 3-vjeçar të

¹GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha standardet (bazuar në kriteret përkatëse). Në fund të çdo rubrike grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

<p>karacterizojnë profilin e programit; Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës; Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>studimeve.</p> <p>Programi i studimit është hartuar deri diku në përputhje me nevojat e tregut të punës, duke gjykuar sipas kurrikulës ekzistuese.</p> <p>Programi i studimit duhet të jetë më i integruar me ekonominë e dijes (know how) për të reflektuar ndryshimet makroekonomike të vendit.</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit; Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme; Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh. në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Sipas RVB, dokumentacionit të programit dhe takimit me titullarët, u konstatua që PS është përshtatur dhe zhvilluar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të IAL.</p> <p>Programi i studimit bachelor në shkenca politko administrative përgjithësisht ka synuar pajisjen e studentëve me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme, ku programi është dezignuar në formë hinke, me lëndët e formimit bazë fillimisht, madje ato teorike për të kulmuar me lëndët e specialitetit dhe ato praktike në fund.</p> <p>Programi i studimit bachelor në shkenca politko administrative ka synuar edhe formimin e shprehive të veçanta ,për të mbuluar gamën e gjerë të problematikës të trajtuar në këtë program specifik.</p>
<p>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</p>	
<p>Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar; Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; 	<p>Programi i studimit bachelor në shkenca politko administrative synon të plotësojë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit makro-ekonomik;</p> <p>Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, ka kryer një studim tregu, i cili përfshin ndër të tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> -mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; -një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; -Ndërkohë nuk ka evidencë se si merret ne konsideratë numri i të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet si motra

d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.	<i>apo kërkesat e punëdhënësve;</i>
Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;	Vumë re se institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;
Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.	Gjithashtu programi i studimit synon të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.
Konkluzione të GVJ: Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Shkenca Politiko-Administrative, gjykojmë se është në përputhje me strategjinë e përgjithshme të Albanian University. Programi në tërësi ka formësuar shprehitë e veçanta për të mbuluar gamën e gjerë të problematikës të trajtuar në këtë program specifik, ka synuar të plotësojë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar. Për këtë qëllim institucioni ka kryer në vitin akademik 2016-2017 edhe një studim tregu.	

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit) **Pjesa përshkrimore**

Universiteti “Albanian University” përbëhet nga 3 Fakultete: Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike. Fakultetet janë njësi kryesore që bashkërendojnë mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore-kërkimore.

Struktura akademike e Fakultetit të Shkencave Shoqërore, e ri-organizuar në përputhje me kërkesat e Ligjit të ri të arsimit të lartë, ka në krye Prof. As. Dr. Fatmir Tartale si Dekan.

Fakulteti i Shkencave Shoqërore përbëhet nga departamentet:

1. Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative
2. Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme
3. Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes
4. Departamenti i Shkencave Juridike

Këshilli i Fakultetit është organ drejtues kolegjal vendimmarrës, i cili drejtohet nga Dekani. Këshilli i fakultetit përbëhet nga anëtarë të stafit akademik, administrativ dhe studentë. Këshilli vepron për një periudhë katër vjecare dhe kompetencat e tij përcaktohen me rregulloren e IAL

Dekani është udhëheqës kryesor i fakultetit. Dekani emërohet dhe shkarkohet nga detyra nga Administratori i Universitetit me propozimin e Senatit Akademik

për një mandat 4 vjeçar me të drejtë riemërimi. Dekani i Fakultetit të Shkencave Shoqërore mban Titullin “ Prof. Asc.Dr ”.

Departamenti është njësi bazë mësimore-shkencore në Fakultet. Departamenti ka për detyrë të nxisë, të bashkërendojë dhe të administrojë veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore duke respektuar liritë akademike të personelit dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare.

Përgjegjësi i Departamentit, është autoriteti më i lartë i njësisë bazë mësimore kërkimore. Përgjegjësi i Departamentit propozohet nga Senati Akademik dhe emërohet nga Administratori me një mandat 4 vjeçar me të drejtë riemërimi.

Programi i Studimit Bachelor në Shkenca Politiko-Administrative është program i ciklit të parë të studimeve, si pjesë e Departamentit të Shkencave Politiko-Administrative, një nga katër departamentet që janë pjesë e Fakultetit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Fakulteti i Shkencave Shoqërore përbëhet nga katër departamente: Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative; Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme; Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes; dhe Departamenti i Shkencave Juridike. Sipas të dhënave që morëm gjatë vizitës në Institucion Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative ka aktualisht në përbërjen e tij për vitin akademik 2016-2017, **16 anëtarë** prej të cilëve **8 janë Personel Akademik Efektiv (PAE)** dhe **8 janë Personel Akademik me Kontratë (PAK)** dhe 7 Personel Administrativ (PA). Nga personeli akademik efektiv (PAE) 5 janë me tituj dhe grada, , ndërsa nga personeli akademik me kontratë (PAK) 3 janë me tituj dhe grada.

Organet e zgjedhura në të gjitha nivelet janë:

Rektori, Këshilli i Fakultetit, Dekani, dhe Përgjegjësi i Departamentit.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

1. Analizë e tregut të punës
2. Rregullore për organizimin dhe funksionimin e ZKMS
3. Rregullore Zyra e Karrierës dhe Alumnit
4. Strategjia e Zhvillimit të Zyrës së Karrierës
5. Ngarkesa Bsc. Shkenca Politiko-Administrative, 2016-2017
6. Ngarkesa totale për stafin, 2016-2017

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit **Pjesa përshkrimore**

Personeli akademik dhe drejtuesit e Fakultetit dhe Departamentit kryejnë veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor ose të aplikuar, shërbime për



zhvillimin e IAL, këshillim për studentët, detyra administrative, në përputhje me detyrat e përcaktuara në statutin e Universitetit "Albanian University" dhe të rregulluara me Kontratën Individuale të Punës, e cila bazohet në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë. Mësimdhënia në këtë PS mbulohet nga Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK) si dhe Personel Administrativ (PA). Mësimdhënia mbulohet kryesisht nga pedagogë të Departamentit të Shkencave Politiko-Administrative, ndërsa një pjesë e moduleve (kryesisht ato me zgjedhje) mbulohen nga pedagogë të Departamenteve të tjera, si ai i Anglishtes. Aktualisht për vitin akademik 2016-2017 numri i studentëve në programin e Shkencave Politiko-Administrative është **102** (25 studentë të tiranës +77 studentë të transferuar nga berati) ky numër i madh është për shkak të transferimit nga filiali i mbyllur i Beratit, dhe kjo ka sjellë dhe nevojën për një shtim të stafit akademik për t'iu përgjigjur më mirë raporteve studentë-pedagogë duke filluar nga viti i ardhshëm akademik. Nga ana tjetër, studentët raportojnë se janë mjaft të kënaqur nga stafi administrativ i cili si sasi dhe si cilësi i'u përgjigjet në kohë reale kërkesave të tyre.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura didaktike (seksionet) për departamentetose programin e studimit

Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative ofron vetëm një program studimi të ciklit të parë, bachelor në shkenca politiko-administrative dhe katër programe të ciklit të dytë si dhe 2 programe të ciklit të tretë.

Sipas të dhënave që morëm gjatë vizitës në institucion gjatë vitit akademik 2016-2017 për këtë program studimi aktualisht janë angazhuar në mësimdhënie gjithsej **17 pedagogë** nga të cilët **9 janë personel akademik efektiv (PAE)**, dhe **8 janë personel akademik me kontratë (PAK)**, nga të cilët më shumë se gjysma janë me tituj dhe grada, duke mbuluar nevojat e raportit student-pedagogë dhe duke plotësuar kërkesat e LAL-së. Të dhënat e raportuara për raportin PAE/PAK (sipas RVB) nga viti 2010-2011 ku ky raport ka qenë 9/11 deri në vitin 2015-2016 ku raporti ka qenë 11/7 tregojnë një konstante në përmisim, ashtu sikundër raporti personel akademik/administrativ/student që ka qenë 20/7/38 në vitin 2010-2011, në vitin 2015-2016 ka qenë në raportin 18/7/65.

Indikatorët që lidhen me Personelin Akademik dhe atë Administrativ janë:

Raporti PAE/PAK në këtë program është 9/8. Në terma përqindje mund të themi 53 %(PAE) me 47 %(PAK).

Raporti Personel Akademik/Personel Administrativ.17/7.Në terma përqindje mund të themi 70 % (PAE) me 30 %(PA).

Raporti Personel Akademik./Student.17/245²

Raporti Personel Administrativ/Student.7/245

² Ky numer perfshin studentet per vitet 2014 - 2016

PAE përbëhet nga disa grup moshë. 2 janë në grup moshën 25-35 vjeç, 6 janë në grupmoshën 36-45 vjeç dhe 1 në grupmoshën 56-65 vjeç. Përbërja e stafit sipas moshës mundëson harmonizimin më të mirë të stafit me përvojë me stafin e ri dhe është një faktor i rëndësishëm për fuqizimin e njësisë.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion u morën të dhëna mbi stafin akademik të departamentit dhe stafin akademik të angazhur në mësimdhënie për këtë program studimi për vitin akademik 2016-2017.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>Albanian University ndjek përgjithësisht procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren. Kjo doli në pah si gjatë shqyrtimit të RVB-së, ashtu dhe nga vëzhgimi në terren, si dhe në bashkëbisedimin me zyrën e burimeve njerëzore dhe pyetjet adresuar pedagogëve me kohë të plotë dhe të pjesshme.</p> <p>Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën 53% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimit të ciklit të parë (BSc) të shkencave politiko-administrative, të paktën për gjatë tre viteve të fundit;</p> <p>Konkretisht personeli akademik me kohë të plotë përbën 9/17 të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi.</p> <p>Albanian University kryesisht ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit. Gjatë vëzhgimit dhe ballafaqimeve në terren si grup i vlerësimit të jashtëm pamë dhe monitoruam se si personeli vlerësohej në mënyrë periodike nga studentët nëpërmjet pyetësorëve, si dhe sikundër raportuan pedagogët, nga përgjegjësi i departamentit, nëpërmjet vizitave në klasë të lajmëruara dhe të palajmëruara një herë në vit për pedagogët e rinj.</p> <p>Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj, të cilat përveçse të raportuara në</p>

	RVB, na u vunë në dispozicion edhe nga zyra e burimeve njerëzore.
Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor,” ose titullin akademik “Docent.”</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore, si dhe Zyra e Brëndshme e Sigurimit të Cilësisë në Albanian University disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në programe studimit, të cilat rakordohen me përgjegjësin e departamentit dhe na u vunë në dispozicion gjatë vizitës në terren, si dhe ishin të përfshira në RVB. Të dhënat nga viti 2010-2011 deri në vitin 205-2016, si për numrin e PAE-ve edhe të PAK, ishin të përfshira në RVB, ndërsa të dhënat e vitit 2016-2017 për të dy kategoritë e sipërcituara na u dërguan nga Institucioni pas kërkesës tonë në takimin me ta. Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>IAL ka përcaktuar kritere dhe procedura të qarta për rekrutimin e PA. Institucioni i publikon ato rregullisht në website, kur lind nevoja për rekrutime të reja. Gjykojmë që kjo është një praktikë e mirë dhe që ndiqet me rigorozitet nga verifikimi që bëme si në zyrën e burimeve njerëzore, ashtu dhe nga cfarë na u tha nga takimi me Znj. Desara Agaj kryetare e Zyrës së Brëndshme të Sigurimit të Cilësisë si dhe me Përgjegjësin e Departamentit të Shkencave Politiko-Administrative.</p>
Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>Nga biseda me studentët e të tre viteve doli në pah vencarisht, se institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për t’iu përgjigjur në kohë reale kërkesave të ndryshme të studentëve. <i>Ky program nuk e përmban realizimin e orëve laboratorike për vete specifikën e tij.</i></p> <p>Gjatë shqyrtimit të RVB-së dhe vëzhgimit në terren pamë se Albanian University përgjithësisht ka një staf të angazhuar në përmbushjen e objektivave të studimeve të ciklit të parë të studimeve në shkencat politiko-administrative. Personeli i vënë në dispozicion nga institucioni është i mjaftueshëm për mësim-dhënie, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve si në praktikën profesionale, ashtu edhe në udhëheqjen e punimeve të diplomës.</p>

	<p>Nga ana tjetër disa pedagogë, si Dr. Alketa Marku apo Dr. Doriana Pano kanë respektivisht një ngarkesë vjetore orësh prej 345 dhe 315 orë për semestër. Gjykojmë që kjo është eksese dhe ngarkesat mësimore për vitin e ardhshëm akademik 2017-2018 duhet të jenë në përputhje me normat e reja të Ligjit të ri të Arsimit të Lartë. Kjo vlen edhe për stafin akademik me kontratë (PAK), ku për shembull Doktorante Entjola Pano, ndonëse ende në proces doktorature ka një normë vjetore prej 210 orësh në vit akademik.</p>
<p>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Nga shqyrtimii RVB-së por edhe gjatë vëzhgimit në terren, <i>nuk pamë të ketë programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit</i> si organizime seminaresh apo workshop-esh të vecante për këtë qëllim. Nga ana tjetër, institucioni inkurajon pedagogët të botojnë te revista Optime e Universitetit, që ka ISSN ndërkombëtare por që nuk është e specializuar për shkencat politike administartive në vecanti por gjeneraliste. Gjithashtu, nga takimet me pedagogët, disa prej tyre pranuan faktin që marrin mbështetje financiare nga Universiteti për pagesat e konferencave si dhe ftesa periodike kur vetë Universiteti organizon konferenca te tilla kombëtare apo ndërkombëtare.</p> <p>Albanian University përgjithësisht disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara, përfshirë këtu specifikisht për programin Bsc në Shkenca Politike-Adiministrative për pesë vitet e fundit.</p>
<p>Konkluzione të GVJ: Albanian University ndjek përgjithësisht procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit; në përputhje me statutin dhe rregulloren. <i>Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë (PAE) për realizimin e programit BSc në Shkenca Politiko-Administrative. përbën 53% të personelit akademik .</i></p> <p>Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj. Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik, <i>por nuk pamë konkretisht të ketë programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit</i> si; organizime seminaresh apo workshop-esh të veçantë për këtë qëllim. Nga ana tjetër, institucioni inkurajon pedagogët të botojnë te revista Optime e Universitetit, që ka ISSN ndërkombëtare por që nuk është e specializuar</p>	

për shkencat politike në vecanti por gjeneraliste. Gjithashtu, nga takimet me pedagogët, disa prej tyre pranuan faktin që marrin mbështetje financiare nga Universiteti për pagesat e konferencave si dhe ftesa periodike kur vetë Universiteti organizon konferenca të tilla kombëtare apo ndërkombëtare.

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkimore

Nga vëzhgimi në terren, pas shqyrtimit paraprak të RVB-së, si grup i vlerësimit të jashtëm, konstatuam se mjediset e Fakultetit të Shkencave Shoqërore dhe specifiku të Departamentit të Shkencave Politiko-Administrative ishin të bollshme, si për salla leksionesh, ashtu edhe seminareve dhe mund të përballonin me lehtësi edhe numrin në rritje të studentëve për shkak të transferimit nga Berati. Gjithashtu konstatuam se sallat e leskioneve dhe një pjesë e sallave të seminareve kishin video-projektorë që lejonin prezantimin e leksioneve nga pedagogët dhe prezantimet individuale ose në grup të studentëve. Libraria ishte e pajisur mjaft mirë nga ana sasiore, ndonëse mendojmë se ka vend për përmisim nga ana cilësore, përse i përket pajisjes me tituj specifikë të përkthyer që i përkasin lëmit të shkencave politike dhe shkencës së administrimit publik. Nga ana tjetër, një ndihmë e madhe ishte libraria elektronike Questia.

Studentët kishin si ankesë kryesore nga ana infrastrukturore, mungesën e parkimit, për shkak se Universiteti është në qendër të Tiranës, gjë që e pamundëson parkimin dhe nuk ka një parkim të vetin. Fakti që Albanian University është i lokalizuar në qendër të Tiranës, e bën objektivisht të perealizueshëm mungesën e kesaj hapësire për parkim, çka shkakton vështirësi jo të vogla si për studentët, ashtu dhe për stafin akademik dhe administrativ.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit janë:

- Salla për leksione **10 salla leksionesh me sipërfaqe gjithsej prej 1120.2 m²**
- Klasa për seminare **20 klasa për seminare me sipërfaqe gjithsej prej 1005 m²**
- Salla për aktivitete promovuese **1 sallë për aktivitete promovuese me sip. 245 m²**
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale **Nuk është e aplikueshme për këtë program studimi**
- Laboratorë për lëndët **1 laborator me sipërfaqe 50 m².**
- Laboratorë informatike **1 laboratorë me sipërfaqe 35 m².**

- Salla interneti **Nuk ka**
- Salla për bibliotekë **1 sallë për bibliotekë me sip. 148.6 m²**
- Mjedis për fotokopjime, librari etj **1 mjedis me sip. 7 m²**
- Zyrë informacioni për studentët **1 mjedis me sip. 6 m²**
- Nyje hidrosanitare **6 të tilla me sip. 106.4 gjithsej**

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/kancelarin **2 zyra me sip. 85 m²**
- Zyra për sekretarinë mësimore **4 me sip. 83 m²**
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore **4 zyra me sip. 80 m²**
- Zyra për personelin akademik **9 zyra me sip. 270 m²**

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Nuk u mor ndonjë dokumentacion specifik për këtë rubrikë, por u vizituan nga afër ambientet dhe u verifikua çfarë ishte raportuar në RVB.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit së RVB-së dhe vëzhgimeve në bibliotekë pamë se Albanian University vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësi.</p> <p>Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit.</p> <p>Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libreria elektronike Questia, të cilat përmbajnë libra të nevojshëm për realizimin me sukses të programit të studimit. <i>Do të ishte një plus që të kishte dhe database të specializuar për artikuj shkencorë si JSTOR, EBSCO, apo edhe Ebrary dhe EMERALD, nëse institucioni do mundësonte disponimin e tyre në funksion të stafit pedagogjik dhe studentëve.</i></p> <p>Përgjegjësi i programit harton një plan vjetor të konsultuar me anëtarët e departamentit për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të.</p> <p>Studentët nuk e shfrytëzojnë sa duhet bibliotekën e Universitetit sic doli në dukje gjatë vizitës në institucion shprehur kjo edhe</p>

nga Dekani i Fakultetit, ndonëse ekziston një fond i konsiderueshëm librash si dhe biblioteka online Questia. jashtëm. *Mendoj të merren masa për gjenerimin e titujve specifike të fushës së shkencave politiko-administrative në vend të librave gjeneralistë si një nga instrumentat për të nxitur vëmendjen e studentëve.*

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit tëstudimeve;

Kriteri 2 Pajisjet e mjedisve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.

Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.

Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.

Nga vëzhgimi në terren dhe duke e ballafaquar me raportin e RVB-së, pamë se institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimit Bsc në Shkenca Politiko-Administrative.

Gjithashtu pamë se pajisjet ndihmëse si monitorë dhe kompjutera në salla leksionesh dhe seminaresh funksiononin dhe na u bë me dije se studentët i përdornin për prezantimet individuale dhe në grupe të punimeve të kurseve të ndryshëm.

Institucioni ka laboratorë por këta nuk janë të aplikueshëm për këtë program specifik studimi. Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, si pjesë e programit të Bsc në Shkenca Politiko-Administrative.

Albanian University ka një memorandum bashkëpunimi me Bashkinë e Tiranës për kryerjen e praktikave profesionale për studentët e Bsc në Shkenca Politiko-Administrative edhe një marrëveshje me DAP-in .

Nga studentët që pyetëm, pjesa më e madhe e tyre kishin siguruar vetë praktikat, si në zyra avokatie etj, ndonëse ata u shprehën se Universiteti u kishte ofruar alternative të tjera në rast se do të kishin vështirësi ta gjenin vetë.

Konkluzione të GVJ: Albanian University vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësi. Ka gjithashtu një bibliotekë me literaturë të mjaftueshme, si dhe librarine elektronike Questia. Do të ishte një plus që të kishte dhe database të specializuar për artikuj shkencorë si JSTOR, EBSCO, apo edhe Ebrary dhe EMERALD, nëse institucioni do mundësonte disponimin e tyre në funksion të stafit pedagogjik dhe studentëve.

Sygjeroj të merren masa për gjenerimin e titujve specifike të fushës së shkencave politiko-administrative në vend të librave gjeneralistë si një nga instrumentat për të

nxitur vëmendjen e studentëve

Gjithashtu pamë se pajisjet ndihmëse si monitorë dhe kompjutera në salla leksionesh dhe seminaresh funksiononin dhe na u bë me dije se studentët i përdornin për prezantimet individuale dhe në grupe të punimeve të kurseve të ndryshëm. Institucioni ka laboratorë por këta nuk janë të aplikueshëm për këtë program specifik studimi.

Albanian University ka një memorandum bashkëpunimi me Bashkinë e Tiranës dhe DAP-in për kryerjen e praktikave profesionale për studentët e Bsc në Shkenca Politiko-Administrative.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkimore

Burimet e financimit bazohen 100 përqind te pagesat e studentëve për ciklin e studimit. Tarifa për student është **1500 euro** për vit akademik që mbulojnë koston për studentë si dhe pagesat e stafit akademik dhe administrativ për studentët e ciklit të parë në shkencat politiko-administrative. Kapacitetet menaxhuese janë brenda normave të specifikuara nga ligji dhe aktet nënligjore në fuqi.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (**në përqindje**):
- Grantet për kërkim **0 %**
 - Konsulencat, shërbimet **0 %**
 - Tarifat për dhe gjatë shkollimit **100 %**
 - Sponsorizimet **0 %**
 - Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm) **0 %**
 - Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj **0 %**
 - Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj **0 %**
- Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje) **100 %**
- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Nuk u mor ndonjë dokumentacion specifik për këtë rubrikë por u vizituan nga afër ambjentet dhe u verifikua çfarë ishte raportuar në RVB.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	

Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.

Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;

Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;

Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.

Nga shqyrtimi i RVB-së dhe të dhënave në formë intervistimi që patëm në zyra të ndryshme gjatë vizitës në vend, pamë që ka një zinxhir komunikimi në lidhje me kërkesat dhe shpenzimet financiare për të cilat bëhet dhe auditimi i përvitshëm. Në raport përfshihen detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet specifike të programit të studimit etj.

VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR

Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.

Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;

Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;

Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.

Vumë re se si departamenti i shkencave politike nuk gjeneron të ardhura shtesë nga ofrimi i konsulencave apo shërbimeve ndaj të tretëve dhe nuk kanë pjesmarrje në ndonjë projekt të financuar nga fondet e BE-së apo përfitues të granteve të ndryshëm. Duket që specifikisht programi i studimeve Bsc në Shkencat Politiko-Administrative financohet 100 përqind nga pagesat e studentëve.

Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen megjithë rënien e numrit të studentëve të rinj (të vitit shkollor 2016-2017) në këtë program studimi sa një të tretën e numrit të regjistruar në vitin paraardhës. Këtu nuk marrim parasysh numrin e studentëve të transferuar nga filiali i Beratit pasi nuk janë gjenerim i të ardhurave shtesë.

Rekomandohet që Albanian University dhe specifikisht Departamenti i Shkencave Politiko-Administrativ të aplikojë për programe europiane të tilla si; Erasmus Plus, Horizon 2020, Socrates etj, të cilat do të sillnin të ardhura shtesë nga projektet e fituara, do të rrisnin partneritetin efektiv dhe konkret me institucione europiane të arsimit të lartë, do të

	integronin stafin akademik në një ambient ndër-disiplinar me përfitime të ndërsjellta, do të ekspozonte studentët ndaj mundësive të reja dhe në përgjithësi do ta bënte departamentit më të pavarur në ushtrimin e autonomisë dhe lirisë akademike që i garanton ligji.
<p><u>Konkluzione të GVJ:</u></p> <p>Departamenti i shkencave politike administrative nuk gjeneron të ardhura shtesë nga ofrimi i konsulencave apo shërbimeve ndaj të tretëve dhe nuk kanë pjesëmarrje në ndonjë projekt të financuar nga fondet e BE-së apo përfitues të granteve të ndryshëm.</p> <p>Duket që specifikisht programi i studimeve në Bsc në shkencat politike-administrative financohet 100 përqind nga pagesat e studentëve.</p> <p>Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen megjithë rënien e numrit të studentëve të rinj (gjatë vitit akademik 2016-2017) në këtë program studimi sa një të tretën e numrit të regjistruar në vitin paraardhës.</p> <p><i>Sygjeroj që Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative të aplikojë për programe europiane të tilla si; Erasmus Plus, Horizon 2020, Socrates etj, të cilat do të sillnin të ardhura shtesë nga projektet e fituara, do të rrisnin partneritetin efektiv dhe konkret me institucione eurëopiane të arsimit të lartë.</i></p>	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Nga shqyrtimi paraprak i RVB-së si dhe nga vizita dhe intervistat në terren, konstatoam një funksionim mjaft efikas të Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, e cila ka një rregullore të sajën dhe një funksionim mjaft efikas qoftë në asistencën për hartimin e RVB-së, qoftë në marrjen e masave për adresim të kërkesave dhe ankesave të studentëve, në kontrollin, asistencën që u jep fakulteteve dhe departamenteve të vecanta, si Departamentit të Shkencave Politiko-Administrative. Mendojmë se ngritja dhe funksionimi real i NJSBC-së, është një nga pikat e forta të Albanian University dhe personeli i NJSBC-së dukej kompetent në ushtrimin e detyrave funksionale. Gjatë vizitës në institucion na u komunikua nga funksionimi i kësaj zyre se në shtator ishin ngritur grupe të njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë deri në nivel departamenti, nga 2 pedagogë për cdo department. Këta pedagogë bënë rishikime të syllabuseve dhe kurrikulave, gjithashtu këto merrnin pjesë edhe në hartimin dhe shkrimin e RVB.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
- Sa anketime kanë bërë me studentët **2 anketime në vit**
 - Sa studentë janë anketuar **41% e numrit total të studentëve të përzgjedhur rastësisht**
 - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë **janë përpunuar të gjitha anketimet dhe të dhënat që kanë dalë janë sasiore dhe cilësore**
 - Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm **problemet janë të ndryshme, të lidhura kryesisht me të mësuarit, kryesisht për studentët e viti të parë dhe të shërbimeve universitare.**

Zyra e NJSBC përbëhej nga:

	Anëtarët e NJSBC	Detyra që ka në NJSBC	Periudha nëkëtëdetyrë
1	Dr. DesaraAgaj	Drejtuese	1 vit
2	Dr.ElonaDoko	Anëtare	1 muaj
3	Msc. SiditaÇoniku	Anëtare	1.5 vite
4.	Prof.Dr. KaliopiNaska	Anëtare nëniveliDepartamenti	6 muaj
5	Dr. BlendiÇali	Anëtare nëniveliDepartamenti	6 muaj

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion u morën të dhëna të abdetura në lidhje me përbërjen e NJSBC

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve; Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional; Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë; Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të	Insitucioni ka metodologji të brendshme për matjen e ecurisë së programeve të studimeve sic doli dhe nga shqyrtimi i raportit të vlerësimit të brendshëm dhe verifikimit në terren. Albanian University ka kryer për herë të parë një Studim të Tregut të Punës përgjatë vitit akademik 2016-2017. Albanian University kryen anketime dy

<p>drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. I provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); Dëgjime në auditor; Vlerësimi me nota/pikë; Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Etj. 	<p>herë në vit për secilin program studimi, përfshirë edhe atë të Bsc në Shkenca Politiko-Administrative ku studentët pyeten për vlerësimin e kurrikulës, stafit pedagogjik etj.</p> <p>Përgjegjës për këtë është Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, me drejtuese znj. Desara Agaj, sic na u konfirmua edhe përgjatë vëzhgimit në Universitet.</p> <p>Gjithashtu institucioni përdor si metoda vlerësimi; dëgjimet në uditor, testimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, provime për module dhe praktikë, si dhe detyra kursi dhe prezantime individuale dhe në grup. Gjatë vizitës te sekretaria mësimore, nëpërmjet përzgjedhjes së kampioneve, si për shembull lëndën; Politika e Ballkanit me pedagogë Kaliopi Naska dhe Dorianana Pano, lëndë e vitit të dytë të programit Bsc Shkenca Politiko-Administrative, pamë se si kriteret vlerësuese ishin provimi përfundimtar me shkrim, punimi dhe prezantimi i tij para klasës, si dhe pjesmarrja e studentëve. Këta komponentë kishin përqindjet korresponduese që merreshin për bazë për vlerësimin përfundimtar.</p>
---	--

VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të</p>	<p>Albanian University është në proces akreditimi institucional me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë të Britanisë së Madhe(QAA).Me urdhër nr. 353, datë 29.08.2013 është akredituar fakulteti i shkencave shoqërore , së bashku me programin “bachelor në shkenca politiko administrative”.</p> <p>Nga shqyrtimi i RVB-së dhe vëzhgimi në terren, na rezultojnë që institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Nga takimi me grupin e NJSBC dhe informacionin e marrë mbi punën që kryen, konstatova që IAL i jep mbështetjen dhe mjetet e nevojshme kësaj njësie për të krijuar të gjitha instrumetnat për sigurimin</p>
--	---

programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

e brendshme të cilësisë.

Gjithashtu institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron.

Albanian University nuk i ka rishikuar, ndryshuar apo amenduar kurrikulat ekzistuese dhe programin e studimit në tërësi të Bsc Shkenca Politiko-Administrative që prej vitit akademik 2010-2011. Kjo ka sjellë lehtësi përsa i përket uniformitetit me filialin e Beratit dhe transferimin e studentëve pas mbylljes me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm të MAS, por nga ana tjetër ka sjellë mosreflektim të ndryshimit të nevojave të tregut të punës dhe ndryshimeve makroekonomike në Shqipëri përgjatë shtatë viteve të fundit.

Programi i Shkencave Politiko - Administrative përgjithësisht përputhet me strategjinë institucionale të Univeritetit të miratuar në përputhje me kërkesat e LAL-së.

Konkluzione të GVJ: Institucioni ka metodologji të brendshme për matjen e ecurisë së programeve të studimeve. Albanian University është në proces akreditimi institucional me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë të Britanisë së Madhe(QAA). Me urdhër nr. 353, datë 29.08.2013 është akredituar FSHSH si dhe programi bachelor në shkenca politiko administrative.

Albanian University ka kryer për herë të parë një Studim të Tregut të Punës përgjatë vitit akademik 2016-2017 i cili na u vu në dispozicion gjatë vizitës në terren. Institucioni përdor metoda të ndryshme vlerësimi si, dëgjimet në auditor, testimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, provime për module dhe praktikë, si dhe detyra kursi dhe prezantime individuale dhe në grup.

Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, në përputhje me Statutin e Universitetit dhe rregulloren e Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësië.

Albanian University nuk i ka rishikuar, ndryshuar apo amenduar kurrikulat ekzistuese dhe programin e studimit në tërësi të Bsc Shkenca Politiko-Administrative që prej vitit akademik 2010-2011, duke sjellë mosreflektim të ndryshimit të nevojave të tregut të punës dhe ndryshimeve makroekonomike në Shqipëri përgjatë shtatë viteve të fundit.

Programi i Shkencave Politiko-Administrative përgjithësisht përputhet me strategjinë institucionale të Univeritetit të miratuar në përputhje me kërkesat e LAL-së.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Misioni dhe objektivi i programit të studimit në shkenca politiko-administrative janë në përputhje me misionin dhe objektivat institucionale, si dhe kompatibël me nevojat e tregut të punës, vëçarisht për sektorin publik, duke u nisur nga vlerësimi i kurrikulës ekzistuese e cila nuk ka ndryshuar në gjashtë vitet e fundit. Plani mësimor ishte i përpunuar qartë me kreditet që korrespondojnë me lëndët dhe modulet përkatëse, ku orët teorike dhe ato praktike (jashtë auditorit), ishin të përcaktuara qartë sikundër e konfirmuam duke parë me anë të kampionimit rastësor në syllabuset e lëndëve të vecanta por edhe e konfirmuam nga bashkëbisedimi me studentë të të treja viteve akademike. Ky program studimi synon të përgatisë profesionistë të administratës publike, diplomatë karriere si dhe punonjës së OJF-ve të ndryshme, apo specialistë me synim karrierën në organizatat ndërkombëtare.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Organizimi i programit të studimit Bachelor në Shkenca Politiko-Administrative është program studimi me kohë të plotë. Ky program realizohet në 3 vite akademike me 180 ECTS në përputhje me planin mësimor të propozuar nga Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative, me vendim të Këshillit të Fakultetit. Programi i studimit është organizuar në tre vite akademike apo 6 semestra në total. Procesi mësimor është i ndërtuar me 4500 orë studimi, nga të cilat 1950 orë janë orë studimi në auditor dhe 2250 orë janë orë studimi individual. Procesi akademik zgjat 30 javë mësimore dhe 6 javë të parashikuara për sesionet normale të provimeve. Studenti zhvillon deri në 25 orë mësimore në auditor për javë.

- 1 vit akademik ka 30____ javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15____ javë mësimore në auditor
- Për leksionet 45__ orë në auditor dhe __50__ orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret 45__ orë në auditor dhe __50__ orë punë e pavarur e studentit
- Për Labororet 0__ orë në auditor dhe __0__ orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikat lëndore 0__ orë në auditor dhe __0__ orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale 0__ orë në auditor dhe __10__ orë punë e pavarur e studentit

- Provimi përfundimtar 0__ orë në auditor dhe __60__ orë punë e pavarur e studentit

- Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara:

Nuk ka ndryshime në planin mësimor krahasuar me atë të licensimit.

- Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Shih Tabelën 6, Aneksi6)

- Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Syllabuset i kanë të gjitha elementët. Ato janë të standartizuara për të gjitha modulet si më poshtë;

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Vitin dhe semestrin kur zhvillohet lënda
- Emrin e pedagogut ose pedagogëve që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit, si për shembulformim karakterizues apo formim i përgjithshëm
- Syllabuset përmbajnë njohuritë paraprake dhe të përgjithshme që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës.
- Çfarë njohurish dhe aftësish të përgjithshme dhe specifike i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe kreditet ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve (me shkrim apo me gojë)
- Detyrimet e studentit për lëndën të tilla si prezantim punim dhe provim me shkrim, si dhe ese apo punim kërkimor-shkencor për lëndët e avancuara
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

- Dokumentacioni përkatës, i marrë në institucion:

Syllabuse të lëndëve të ndryshme si Politikat në Ballkan etj.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	Albanian University në përputhje me kërkesat e ligjit të LAL ofron programin e studimit në ciklin e parë Bsc në Shkenca Politiko-Administrative, të organizuar në

Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;

module dhe të vlerësuar në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Në këtë program specifikisht disiplina të formimit të përgjithshëm bazë zënë 35 ECTS, disiplina të formimit karakterizues janë ekuivalente me 93 ECTS;disiplina formuese të ngjashme ose itegruese me disiplinat e sipërpërmendura janë ekuivalente me 12 ECTS;disiplinat formuese me zgjedhje baraz me 12 ECTS, veprimtaritë formuese për njohje të gjuhës së huaj, informatikë dhe praktika mësimore përbëjnë 22 ECTC dhe teza e diplomës në fund është e barabartë me 6 ECTS.
Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite.

II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.

Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;

Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;

Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.

Gjatë vizitës në Universitet dhe gjatë takimit me drejtuesin e njësisë kryesore na u dha informacioni i nevojshëm për përmbajtjen e programeve të studimit, për lëndët e detyrueshme dhe ato me zgjedhje.

Studentëve iu ofrohet informacion në lidhje me programin e studimit që në fillim të procesit mësimor. Studentëve iu vihet në dispozicion plani mësimor dhe programet e lëndëve.

Gjithashtu jepej edhe ngarkesa mësimore e stafit PAE dhe PAK, orët në auditor, frekuentimin e programit etj., të cilat përputheshin plotësisht me të dhënat e pasqyruara në RVB për pesë vitet e fundit akademikë.

Konkluzionet e GVJ:

Programi i studimit bachelor në shkenca politiko-administrative është akredituar me urdher nr. 353. date 29.08.2013.

Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite.

Gjatë vizitës në Universitet dhe gjatë takimit me drejtuesin e njësisë kryesore na u

dha informacioni i nevojshëm për përmbajtjen e programeve të studimit, për lëndët e detyrueshme dhe ato me zgjedhje, për ngarkesën mësimore të stafit PAE dhe PAK, orët në auditor, frekuentimin e programit etj, të cilat përputheshin plotësisht me të dhënat e pasqyruara në RVB për pesë vitet e fundit akademikë.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkimore

Organizimi i mësimdhënies është dhënë me ndarjen e orëve në leksione dhe seminare, si dhe ndarjen tematike të orëve teorike dhe praktike. Ngarkesa e pedagogëve me kohë të plotë ishte në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë dhe më përjashtim të ndonjë rasti, edhe ngarkesa akademike e PAK-ve. Teknologjia e mësimdhënies përfshin përdorime të multi-medias, në lëndë të caktuara si metodat e kërkimit, punë në terren me anketime etj. Aktivizimi i studentëve ishte në nivele të kënaqshme dhe një pjesë e tyre u ndjenë të privilegjuar që ishin lejuar si vëzhgues të zgjedhjeve parlamentare të qershorit 2017 nga KQZ-ja me ndihmën dhe nën udhëheqjen e njërit prej pedagogëve të jashtëm.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:
- Format e organizimit të mësimdhënies janë leksionet, seminarët, detyrat e kursit dhe punime të parashikuara në programin mësimor, sipas rregullores së këtij programi studimi. Sipas të dhënave të planit mësimor, syllabuseve dhe takimit me stafin dhe studentët, mësimdhënia realizohet kryesisht me leksione.
- Seminarët zhvillohen rregullisht dhe në përputhje me planin mësimor.
- Ushtrimet janë pjesë e rregullt e detyrave të kursit.
- Laboratorët nuk janë të aplikueshëm për këtë program studimi.
- Praktikë lëndore **Nuk ka**
- Praktikë profesionale Institucioni ka një sërë marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e praktikave profesionale si psh me; **Bashkinë Tiranë, Kompaninë Delta, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Drejtorinë e Burgjeve, Departamentin e Administratës Publike, Kryqin e Kuq Shqiptar etj.**

Format e kontrollit të njohurive ishin **me shkrim dhe me gojë**. Format e kontrollit dhe formula e vlerësimit të studentit për cdo lëndë, është pjesë e syllabus-it të lëndëve. Në fillim të cdo semestri pedagogët u bëjnë të ditur studentëve modelin dhe formulën e zgjedhur për vlerësimin e njohurive të tyre përgjatë semestrit dhe në fund të tij

- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj:

16 studentë të aktivizuar në projekte shkencore në rang Fakulteti.

0 studentë të angazhuar në projekte shkencore në rang Departamenti apo për projekte shkencore individuale të pedagogëve apo në bashkëpunim me të tjetrë.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Procedurat e pranimit të studentëve për herë të parë apo atyre të transferuar ishin konform ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi sikundër inspektuam te zyra e rregjistrave me grupin e jashtëm të vlerësimit. Koha mesatare e studimeve ishte 3 vite akademike, kalueshmëria e studentëve nuk paraqitej problematike dhe ishte brenda normave të lejuara. Përsa i përket punësimit, ishte mjaft i ulët për të punësuarit në profesion por përgjithësisht mbi mesataren si nivel i përgjithshëm punësimi. Nuk disponojmë ndonjë statistikë për punësimin ekzakt të studentëve të diplomuar në fusha që kanë lidhje të drejtëpërdrejtë me studimet apo në fusha analoge përveç atyre që na u transmetuan gojarisht nga zyra e NJSBC-së, zyra e Alumni dhe Karrierës dhe Dekanati. Mendojmë se informimi i studentëve në lidhje me karrierën ishte në nivele të kënaqshme duke qenë se ishte një zyrë e posacme me një koordinator me kohë të plotë në dispozicion për këtë qëllim.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve ishin të qarta dhe në përputhje me LAL dhe rregulloren e brendshme të Universitetit. Më specifikisht dokumentat që duhet të paraqesin studentët për tu regjistruar në këtë program studimi janë:
 - Diplomë e maturës shtetërore së bashku me çertifikatën e notave.
 - Dëftesën e shkollës së mesme të fituar jashtë vendit.
 - Dëftesë pjekurie të shkollës së mesme (kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara vitit 2011)
 - Fotokopje e kartës së identitetit, letër njoftimit ose pasaportës.
 - 4 fotografi
 - Formulari i aplikimit
- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve 6.7 mesatarja në hyrje e studentëve
- Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Gjatë vizitës në institucion morëm tabelën përkatëse ku rezulton se studentë të rregjistruar për vitin e I (2016-2017) janë **102 studentë** nga ku 22 studentë për herë të parë + 80 studentë të transferuar nga Berati.
- Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Viti 2015-2016: **16**
Nota Mesatare e vitit 2015-2016 është **6.78**.
- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend **I kufizuar**.
- Të dhëna për punësimin e studentëve **42 studentë për vitet akademike 2010-2015;**
- Numri total të diplomuarve **109 për vitet 2010-2014**
- Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën) **17 studentë për vitet akademike 2010-2015;**

- ☑ Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën) **25 studentë të punësuar jo në përputhje me diplomën**

Numri i studentëve për Bsc në Shkenca Politiko-Administrative			
Viti akademik	Studentë të rregjistruar për herë të parë	Studentë të rregjistruar në vite të ndërmjetme	Numri total i studentëve për vit akademik
2010 - 2011	38	4	42
2011 - 2012	23	5	28
2012 - 2013	24	10	34
2013 - 2014	11	5	16
2014 - 2015	33	42	75
2015 - 2016	65	3	68
2016 - 2017	22	80	102

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbyshja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.	
<p>Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të RVB-së dhe e përforcuar nga vizita në terren, pamë se pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Nuk kishin kriteret specifike për pranimin e studentëve në këtë program studimi.</p>
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p>Kriteri 4 Studentët informohen mbi</p>	<p>Nga biseda që patëm me studentët, na u bë me dije se ata informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit Gjithashtu ata njoftoheshin edhe nga Përgjegjësi i Departamentit, nga zyra e Këshillimit Studentor dhe nga studentja që përfaqëson programin e Shkencave Politiko-Administrative në Klubin</p>

mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.

Studentor.
Gjithashtu stafi pedagogjik dhe studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit.
Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës përgjatë tre viteve që zgjat programi i studimeve.
Gjithashtu studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.

Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.

Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;

Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;

Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.

Nga vizita në institucion vëzhguam se Albanian University disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë per Shkencat Politiko-Administrative.

Numri i studentëve të diplomuar për vit akademik rezulton si më poshtë;

2010-2011 rezultojnë **31 studentë**;
2011-2012 rezultojnë **18 studentë**
2012-2013 rezultojnë **38 studentë**
2013-2014 rezultojnë **22 studentë**

Numri i studentëve të diplomuar në këtë PS për periudhën 2010 – 2013 është **109 studentë**.

Numri i studentëve paraqet qëndrueshmëri dhe në vitin e fundit akademik (2016-2017 ku ka gjithsej 102 studentë. Ka ndihmuar në këtë drejtim dukshëm edhe transferimi nga filali i Beratit pas mbylljes së këtij të fundit me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm të MAS. Vlerësojmë që transferimi i studentëve është bërë konform rregullave, nuk ka krijuar probleme për shkak të kurrikulës së njëjtë dhe pjesa më e madhe e studentëve janë matrikuluar, ndërsa një pjesë e vogël janë ende në proces matrikulimi. Universiteti akordon disa bursa sociale konkretisht për studentët e programit të shkencave politiko-administrative nga të cilat 3 janë në vit të dytë, 1 në vit të parë dhe 1 në vit të tretë. Gjithashtu Albanian University ofron bursa ekselence ose gjysëm bursa për studentët me mesatare

	<p>10 dhe 9.5 respektivisht. Gjatë takimit me studentët arritëm të takonim një prej këtyre studentëve me mesatare 9.5</p> <p>Gjithashtu nga sekretaria mësimore, na u vu në dispozicion informacioni se institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimi.</p> <p>Institucioni duket se disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>
--	--

Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.

<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Gjatë takimit me koordinatoren e zyrës së Këshillimit të Karrierës, na u bë me dije se Albanian University u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor.</p> <p>Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>
--	--

Konkluzionet e GVJ

Pranimi i studentëve në Albanina University për ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi. Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit. Gjithashtu stafi pedagogjik dhe studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit. IAL disponon statistika për numrin e studentëve që ndjekin këtë PS dhe numrin e studentëve të punësuar pas diplomimit.

Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës përgjatë tre viteve që zgjat programi i studimeve. Gjithashtu studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.

Universiteti ka të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve nga pranimi deri në diplomim. Gjithashtu institucioni ofron këshillim karriere studentëve dhe ndjek progresin e tyre.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkimore

Politikat e kërkimit shkencor konsistojnë në zhvillimin e të paktën një konference shkencore në vit nga institucioni i cili merrte përsipër si koston e organizimit, ashtu edhe të publikimit të proceedings, por kishte pak mbështetje financiare apo logjistike për profesorët për të ndjekur konferenca të mirëfillta ndërkombëtare në vendet e BE-së apo OECD-së. Gjithashtu, Albanian University ka revistën shkencore gjeneraliste Optime, por gjykojmë që kjo revistë është larg të qënurit një revistë e specializuar që do t'i shërbente nevojave për publikime të mirëfillta të stafit akademik dhe doktorantëve në fushën e shkencave politiko-administrative.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL (55)
- Numri i projekteve kërkimore të fituara (0)
- Numri i projekteve të zbatuara (0)
- Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL (15)
- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL (6)
- Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor (0)
- Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor (0)
- Numri i Çmimeve Kombëtare (0)
- Dokumentacioni përkatës i marrë gjatë vizitave (0)

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkimore

Bashkëpunimet ndërkombëtare të Albanian University sic na u tha nga Dekani i Fakultetit të Shkencave Shoqërore dhe Përgjegjësi i Departamentit të Shkencave Politiko-Administrative, konsistojnë në memorandume bashkëpunimi me Universitetet italiane të Pizzës dhe Palermos dhe Universitetin Corvinus në Hungari. *Këto bashkëpunime në fakt janë për profesoratit e ciklit të tretë të studimeve (dokloratës) dhe nuk afektojnë ciklin e parë të studimeve Bsc në Shkenca Politiko-Administrative.* Gjithashtu Universiteti ka disa marrëveshje (memorandume) mirëkuptimi me disa institucione publike (si Bashkia e Tiranës dhe DAP) apo private (DAST) për kryerjen e praktikave mësimore që përfshin studentët e ciklit të parë (BSc) në Shkenca Politiko-Administrative.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- ☑ Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar
 - Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare **(0)**
 - Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj **(0)**
 - Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit **(0)**
 - Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL *Janë disa studentë, por pjesa më e madhe absolutisht të transferuar nga filiali i mbyllur i Beratit i Albanian University*
 - Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor
Ka vend për përmisim, vencarisht në drejtim të përfshirjes së më shumë database të kërkimit shkencorë që garantojnë aksesin në revista shkencore të specializuar si dhe financim të konferencave shkencore në vendet e OECD-së për stafin akademik të programit të shkencave politiko-administrative.
 - Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime *Ka vend për përmisim dhe stimulim të aktivitetit shkencor të stafit.*

- ☑ Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:
 - Institucionet qeveritare bashkëpunuese *Po (DAP, Bashkia e Tiranës)*
 - Organizatat Profesionale *Po (Instituti i Sociologjisë, dhe Instituti i Studimeve Politike)*
 - Komuniteti i biznesit, tregu i punës *Po (DELTA- Kompani, për kryerjen e praktikave profesionale)*

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME	
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	
Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit; Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre,	Universiteti për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit. Nga vizita në terren konstatojmë që ka një ndarje të mirë të detyrave si brenda departamentit, ashtu dhe mes zyrave të ndryshme administrative. Një shembull që vumë re ishte funksionimi i pavarur i Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes për mbarëvajtjen e jetës studentore

<p>garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>që merret dhe me organizimin e Open Day dhe përgatit Manualin e Studentit, si dhe Zyrës së Karrierës dhe Alumnit që ndjek karrierën e studentëve. Të ndiqet praktika e mirë si me zhvillimin e aktivitetit “Pjesmarrja në Demokraci. Zgjedhjet dhe Raporti me të Zgjedhurit”, ku propozimi i zyrës së karrierës, koordinimit dhe mbështetjes së studentëve gjeti miratimin e Dekanit Prof.Asoc. Dr. Fatmir Tartale, shkresë e cila na u vu në dispozicion edhe gjatë vizitës në terren.</p>
<p>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj; Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë; Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit; Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Albanian University ka një marrëveshje me Universitetin e Palermos për shkëmbimet e profesioratit të ciklit të tretë (doktoraturës) për programin e shkencave politike sic na u konfirmua nga Drejtuesi i Njësisë Kryesore gjatë takimit. Universiteti ka marrëveshje me Bashkinë e Tiranës për kryerjen e praktikës mësimore të studentëve të ciklit të parë të shkencave politiko-administrative. <i>Institucioni duhet të bëjë një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programit të studimit Bsc në Shkenca Politiko-Administrative.</i></p>
<p>Konkluzionet e GVJ Universiteti për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit. Nga vizita në terren konstatuam që ka një ndarje të mirë të detyrave si brenda departamentit, ashtu dhe mes zyrave të ndryshme administrative. Një shembull që vumë re ishte funksionimi i pavarur i Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes për mbarëvajtjen e jetës studentore që merret dhe me organizimin e Open Day dhe përgatit Manualin e Studentit, si dhe Zyrës së Karrierës dhe Alumnit që ndjek karrierën e studentëve. Albanian University ka një marrëveshje me Universitetin e Palermos për shkëmbimet e profesioratit të ciklit të tretë (doktoraturës) Për programin e shkencave politike sic na u konfirmua nga Drejtuesi i Njësisë Kryesore gjatë takimit. Universiteti ka marrëveshje me Bashkinë e Tiranës për kryerjen e praktikës mësimore të studentëve të ciklit të parë të shkencave politiko-administrative.</p>	

Institucioni duhet të bëjë një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programit të studimeve në Bsc shkenca politiko-administrative. ntëve.



I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Me Urdhër Nr. 353, datë 29.08.2013 *“për heqjen e kushteve të akreditimit për programin e studimit të ciklit të parë “bachelor” në “shkenca politiko administrative” të universitetit privat “albanian university”, këtij program studimi i janë hequr kushtet e vendosura sipas Urdhërit nr. 77, datë 09.04.2009 “për akreditimin me kusht të fakultetit të shkencave shoqërore dhe të programit të studimit “shkenca politiko administrative të shkollës së lartë universitare private “ufo dental”*

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SËOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, ËEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

- 1) Tregues cilësor të personelit akademik të brendshëm dhe të jashtëm që garantojnë përmbushje të qëllimeve të programeve të studimeve.
- 2) Qëndrueshmëri e numrit të studentëve që nga viti akademik 2010 e në vazhdim.
- 3) Marrëveshje bashkëpunimi me institucionet arsimore dhe të fushave të tjera në funksion të zhvillimit të Institucionit dhe të realizimit të programit studimor.
- 4) Universiteti ofron bursa sociale për studentët, të cilat jepen për arsye pamjaftueshmërie financiare ose për shkak të përfshirjes së tyre në punë në shërbim të komuniteteve dhe në mbështetje të shtresave në nevojë.
- 5) Praktikë pozitive mbajtja e rregullt e leksioneve të hapura dhe të dokumentuara përkatësisht.
- 6) Rekrutimi i stafit akademik si PAE, edhe PAK, i kryer në përputhje me kërkesat ligjore të LAL dhe akteve nënligjore në fuqi.

b. Pika të dobëta:

- 1) Të ndryshohet plani mësimor me atë të liqensimit sipas strukturave makro-ekonomike që ka ndryshuar në këto shtatë vitet e fundit.
- 2) Departamenti i shkencave politike nuk gjeneron të ardhura shtesë nga ofrimi i konsulencave apo shërbimeve ndaj të tretëve dhe nuk kanë pjesmarrje në ndonjë projekt të financuar nga fondet e BE-së apo përfitues të granteve të ndryshëm. Programi i studimeve në shkencat politike-administrative financohet 100 përqind nga pagesat e studentëve.
- 3) Pamjaftueshmëria e titujve specifikë të fushës së shkencave politike administrative si një nga instrumentat për të nxitur vëmendjen e studentëve .
- 4) Përfshirje e kufizuar e studentëve në veprimtarinë kërkimore të Departamentit.

- 5) Pjesëmarrje e kufizuar në projekte dhe programe specifike kombëtare dhe ndërkombëtare për kualifikimin e stafit.
- 6) Pjesëmarrja e stafit në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare nuk mbështetet mjaftueshëm nga ana financiare.

c. Mundësitë:

- 1) Mundësitë për punësim edhe sipas një studimi tregu të bërë nga institucioni ngelen kryesisht të orientuara nga administrata publike për shkak të skepticizmit të sektorit privat. Ndërkohë janë disi të reduktuara edhe për shkak të konkueshmërisë nga programet simotra të cilat duhet të merren në konsideratë për specifikat që kanë.
- 2) Reduktimi i ngarkesës vjetore për disa nga pedagogët që e kanë aktualisht ekseseve duke u bazuar në kërkesat e Ligjit të Ri të Arsimit të Lartë dhe akteve nënligjore që rregullojnë ngarkesën maksimale të pedagogë të brendshëm dhe të jashtëm.
- 3) Mundësi, në sajë të emrit të krijuar në treg të Universitetit, të tërheqjes së pedagogëve të kualifikuar jashtë vendit.
- 4) Zhvillimi i më shumë aktiviteteve ekstrakurrikulare nga të cilat do të përfitonin vençarisht studentët por edhe stafi akademik.
- 5) Marrëveshjet e bashkëpunimit me IAL të huaja për kualifikimin e stafit akademik.
- 6) Institucioni duhet të bëjë një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programit të studimeve në Bsc shkenca politiko-administrative.

d. Pengesat:

- 1) Fakti që Albanian University është i lokalizuar në qendër të Tiranës, është problematik për mungesën e hapësirës për parkim, çka shkakton vështirësi jo të vogla si për studentët, ashtu dhe për stafin akademik dhe administrativ.
- 2) Mungesa e kulturës së pranimit të praktikantëve nga institucionet private dhe shtetërore në vend, çon në vështirësi për organizimin e praktikës (pjesë e kurrikulës mësimore) për studentët.
- 3) Mungesa e akteve nënligjore pengon implementimin e ligjit 80/2015 për Arsimin e Lartë.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Ph.D. Ilir Kalemaj

